

## **Komunikatë për media**

**21 Nëntor, 2007**

### **Privatizohet IMK Fabrika e Tubave**

**Prishtinë-** Kemi kënaqësinë të ju njoftojmë se IMK Fabrika e Tubave tanimë është privatizuar tërësisht përmes spinofit special dhe pronarit të ri i është bërë dorëzimi nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM).

Në këtë ndërmarrje të privatizuar përmes spin-of-it special zotimet për punësim janë 360 vende pune, ndërsa zotimet për investime janë 13,2 milion euro. Pronari i ri ka informuar AKM-në rreth qëllimeve për të rikthyer prodhimin në këtë ndërmarrje sa më shpejtë që të jetë e mundur si dhe rreth qëllimeve për të rritur punësimin në këtë ndërmarrje.

Pasi që nuk ka garantim se punëtorët e mëhershëm do të ri-punësohen, AKM sinqerisht shpreson se të gjithë punëtorët e mëhershëm do të punësohen gjatë periudhës kur ndërmarrja të filloj rimëkëmbjen.

Privatizimi i kësaj ndërmarrje paraqet një lajm shumë pozitiv për popullatën e Ferizajt si dhe për promovimin e aktiviteteve të ardhshme të biznesit në këtë rajon.

Pronari i ri fton të interesuarit, posaçërisht punëtorët e mëparshëm të IMN fabrikës së Tubave, që të dorëzojnë aplikacionet për punësim të cilat mund të merren në hyrjen e IMK Fabrikës së Tubave.